



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA EKONOMIKE DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCËS

PROJEKT-VENDIM

Nr. 14, datë 18.11.2025

PËR

NDRYSHIMIN E VKB NR 84 DATË 23.12.2024 "PËR SHITESËN E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE TË BASHKISË VAU DEJËS", SIPAS AKTIT NORMATIV NR. 10 DATE 08.10.2025 "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.115/2024 "PËR BUXHETIN E VITIT 2025"

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës _____.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9, neni 34, 37, 40, 54 shkronja "dh" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; neni 4, kreu III, nenet 10, kreu IV, nenet 22-24, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Ligjin 115/2024 "Per buxhetin e vitit 2025", Udhëzimin Plotësues nr 1 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025, VKB-ne nr 84 datë 23.12.2024 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025 – 2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës ", dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025, Sipas Aktit Normativ nr 10 , datë 08.10.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar ,sipas shkresës nr 14505/11 prot datë 24.10.2025 "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr 10 datë 08.10.2025 " dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës;

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e VKB nr. 84 datë 23.12.2024 , "Për shtesën e transfertës të pakushtëzuar sektoriale të Bashkisë Vau Dejës" sipas aktit normativ nr. 10 date 08.10.2025" "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025"
2. Të miratojë shpërndarjen e shtesës së transfertës së pakushtëzuar sektoriale të Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë:

Adresa: Rruga " Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006,ëeb: ëëë.vaudejes.gov.al, e-mail: info@vaudejes.gov.al

- a) Të miratojë shpërndarjen e shtesës së transfertës së pakushtëzuar sektoriale të bashkisë, të parashikuar sipas programeve buxhetore, për vitin 2025, të ndara sipas tabelës nr 1, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.
- b) Të miratojë shtesën e fondeve CASH me kapitull 01 (transferte e pakushtëzuar sektoriale) të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitet 2025-2027 , të ndara në korente dhe kapitale; sipas tabelës 2, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.

1. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

2. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kristian SHKRELI

Me Vendim Delegimi
ZV/KRYETAR
Aleksandra Gjoni



Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Drejtoria Juridike, Prokurimeve, Integrimit dhe Aseteve

Mbrotja nga zjarri dhe shpetimi

Institucioni: Bashkia Vau Dejës

Tabela Nr 1: " Shpërndarje e transferitës së pakushtëzuar sektoriale për vitin 2025"
Sipas Aktit Normativ nr 10 date 08.10.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025

PAKESOHET

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Emër Institucioni	Kap.	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti	Emërtimi i Projektit
157/00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	01	03280	6040000	3333	90001AA	2,790,000.00	
SHUMA TOTALE										
									2,790,000.00	

Në Lekë

SHTOHET

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Emër Institucioni	Kap.	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti	Emërtimi i Projektit
157/00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	01	03280	6020000	3333	9999999	2,790,000.00	
SHUMA TOTALE										
									2,790,000.00	

Në Lekë

Nëpunësi Zbatues
Elsa Tanushi



Institucioni: Bashkia Vau Dejës

Tabela Nr 2: "Shtesë CASH-I për Kap 01 ,Llogaria Ekonomike 6029999 ,Programi 03280".

Sipas Aktit Normativ nr 10 date 08.10.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025

SHTOHET

Në Lekë

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Emër Institucionit	Kap.	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti	Emërtimi i Projektit
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	01	03280	6029999	3333	9999999	2,790,000	
SHUMA TOTALE Kap 01										2,790,000

Nëpunësi Zbatues
Elsa Tanushi




RELACION

PËR

PROJEKT VENDIMIN

NDRYSHIMIN E VKB-në NR 84 DATË 23.12.2024 “PËR SHITESËN E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE TË BASHKISË VAU DEJËS”, SIPAS AKTIT NORMATIV NR. 10 DATE 08.10.2025 “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.115/2024 “PËR BUXHETIN E VITIT 2025”

QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projekt vendim ka për qëllim përmirësimin e Vendimit të Këshillit nr 84 datë 23.12.2024 “Për shtesën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale të Bashkisë Vau Dejës, sipas Aktit Normativ nr.10 datë 08.10.2025” për Bashkinë Vau Dejës të konfirmuar nga Prefektura Shkodër me shkresë nr 860/1 prot datë 06.01.2025.

Ministria e Financës me shkresën nr. 14505/11 Prot, datë 08.10.2025, me lëndë “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr 10 datë 08.10.2025”, ka dërguar detajimin e shtesës së fondeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore në transfertën e pakushtëzuar sektoriale për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi . Ky fond akordohet për ti ndihmuar bashkitë për shpërblimin e punonjësve të angazhuar në shuarjen e zjarreve , në masën deri në një pagë.

Në shkresë cilesohet që për bashkitë që kanë akorduar shpërblimin e punonjësve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi nga buxheti i tyre do ta përdorin këtë fond për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

Sipas Vendimit Nr. 483 datë 2.9.2025 PËR DHËNIE SHPËRBLIMI PERSONELIT TË ANGZHUAR NË OPERACIONET PËR SHUARJEN E ZJARREVE GJATË VITIT 2025 , pika 9) Efeki financiar për strukturat e përcaktuara në shkronjën "d", të pikës 2, të këtij vendimi, përballohet nga buxhetet përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore , ne kemi përdorur fondet nga buxheti i bashkisë për kalimin e shpërblimeve të punonjësve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi , konkretisht pagesat me urdhër shpenzimin nr 664 dhe urdhër shpenzimi nr 665.

Bazur në aktin normativ nr.10 datë 08.10.2025, nëpërmjet këtij projekt vendimi jemi angazhuar që këto fonde të kalojnë në llogarinë ekonomike 602 për shpenzimet operative , për programin 03280 që të përdoren në vazhdimësi për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimit që mbulon ky program .

Kemi bërë ndryshimet perkatëse sipas tabelave bashkengjitur, pjesë përbërëse të këtij projekt vendimi.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është në harmoni të plotë me:

- Ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar,
- Ligjit nr. 68/2017 ”Për financat e veteqeverisjes vendore, i ndryshuar
- Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar,
- Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar;
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”
- Ligji 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025"
- Udhëzimit Plotesues nr 02 date 24.01.2025 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2025"
- Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 84 datë 23.12.2024 “Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025 – 2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025
- Shkresa Nr 14505/11 prot datë 24.10.2025 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.10 datë 08.10.2025 , dërguar nga Ministria e Financave.

Bashkëngjitur gjeni:

- Kopjen e Vendimit Nr. 483 datë 2.9.2025

Konceptoi:Armena Zagani
Miratoi:Elsa Tanushi



KRYETAR
Kristian Shkreli

ME VENDIM DELEGIMI


ZV/KRYETAR

Aleksandra Gjoni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



CM. 4955 Post
28.09.2025

V E N D I M

Nr. 483, datë 2.9.2025

P Ë R

DHËNIE SHPËRBLIMI PERSONELIT TË ANGAZHUAR
NË OPERACIONET PËR SHUARJEN E ZJARREVE GJATË
VITIT 2025

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Dhënie shpërblimi personelit, punonjës shtetërorë, të angazhuar në shuarjen e zjarreve gjatë verës së vitit 2025.
2. Shpërblehen punonjësit e:
 - a) Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë;
 - b) Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;
 - c) Policisë së Shtetit;
 - ç) Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin;
 - d) Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin në bashki.

3. Punonjësit e përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, përfitojnë shpërblim, sipas kohëzgjatjes së angazhimit, si më poshtë vijon:
 - a) Për angazhim me kohëzgjatje, nga 1 (një) deri në 7 (shtatë) ditë, jepet shpërblim në masën e 1 (një) page mujore;
 - b) Për angazhim me kohëzgjatje, nga 8 (tetë) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, jepet shpërblim në masën e 2 (dy) pagave mujore;
 - c) Për angazhim me kohëzgjatje 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë e më shumë jepet shpërblim në masën e 3 (tri) pagave mujore.
4. Shpërblimi llogaritet mbi bazën e pagës mujore bruto të punonjësit të angazhuar në operacionet e shuarjes së zjarreve.
5. Efekti financiar për strukturat e përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të pikës 2, të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2025.
6. Në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, në shpenzimet korrente, shtohet fondi prej 193 140 098 (njëqind e nëntëdhjetë e tre milionë e njëqind e dyzet mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekësh, përkatësisht 145 809 950 (njëqind e dyzet e pesë milionë e tetëqind e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë në programin buxhetor "Forcat e luftimit", 43 408 127 (dyzet e tre milionë e katërqind e tetë mijë e njëqind e njëzet e shtatë) lekë në programin buxhetor "Mbështetja e luftimit" dhe 3 922 021 (tre milionë e nëntëqind e njëzet e dy mijë e njëzet e një) lekë në programin buxhetor "Emergjencat civile".
7. Në buxhetin e Ministrisë së Brendshme, në shpenzimet korrente, shtohet fondi prej 69 615 100 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind) lekësh në programin buxhetor "Policia e Shtetit".
8. Efekti financiar për strukturën e përcaktuar në shkronjën "ç", të pikës 2, të këtij vendimi, përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2025 për Ministrinë e Brendshme.
9. Efekti financiar për strukturat e përcaktuara në shkronjën "d", të pikës 2, të këtij vendimi, përballohet nga buxhetet përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I MBROJTJES

PIRRO VËNGU